



01-1926

	<p><b>Republika e Kosovës</b>          Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b>          Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
----------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-192405/20 dt. 21.10.2020, të pronarit Qazim Bajgora nga Podujeva, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste, ndërtuar në sheshin “Bill Klinton”, në lagjen Lakërishte, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 30.11.2021, lëshon këtë:

**C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T**

- I. I LEJOHET** Qazim Bajgora nga Podujeva, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-192405/20 dt. 21.10.2020, përdorimi i lokalit afaristë për të cilin është bërë ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0089751/18 dt. 04.07.2018, të evidentuar në certifikatën e pronësisë O-71914059-07230-0-227-0-3-0, ZK Prishtinë.
- II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në sheshin “Bill Klinton”, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e lokalit në evidencat e regjistrit kadastral.
- VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

**A r s y e t i m**

Pronari Qazim Bajgora nga Podujeva, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-192405/20 dt. 21.10.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për lokalit afaristë për të cilin është bërë ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste, të ndërtuara në sheshin “Bill Klinton”, në lagjen Lakërishte në Prishtinë, konkretisht i të evidentuar në certifikatën e pronësisë O-71914059-07230-0-227-0-3-0, ZK Prishtinë, ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste është bërë sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-0089751/18 dt. 04.07.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Me shkresën 05-351/05-85353/18 të datës 17.05.2021 pala ka dorëzuar formularin mbi inspektimin final të punëve nga Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e

betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Hysen Hoda me nr. të licensës 175;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-192405/20 DT. 30.11.2021**

Zyrtari:  
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit  
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori:  
Arbëllan Olluri

